



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më

Nr.

prot.

Data: 24.2.2025

Nr: 152

Ora: 14:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË POLITIKE “PARTIA E LIRISË”, ME
KRYETAR Z. ILIR METAJ, PËR REGJISTRIMIN SI SUBJEKT ZGJEDHOR, PËR
ZGJEDHJET PËR KUVEND, TË DATËS 11 MAJ 2025**

Sot, më datë 24.2.2025, në seancë publike, mora në shqyrtim kërkesën me nr. 1162 prot., datë 20.2.2025, me:

KËRKUES: Partia politike “Partia e Lirisë”, me kryetar z. Ilir Metaj

OBJEKTI: Regjistrimi i partisë politike “Partia e Lirisë” si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025

BAZA LIGJORE: Neni 64, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

V Ë R E J:

Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 399, datë 5.12.2024, ka caktuar datën 11 Maj 2025 për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë.

“Partia e Lirisë”, nëpërmjet Kryetarit z. Ilir Metaj, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvend, që do të zhvillohen më datë 11 Maj 2025.

Data: 24.2.2025 Nr:152
Ora: 14:00



“Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike “Partia e Lirisë”, me Kryetar z. Ilir Metaj për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025”

Bashkëlidhur kërkesës është paraqitur dokumentacioni vijues:

- a) Vërtetimi i lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë, datë 20.2.2025, nëpërmjet të cilit vërtetohet se “Partia e Lirisë”, me initiale “PL”, me Kryetar z. Ilir Metaj, rezulton e regjistruar në dokumentacionin e kësaj Zyre.
- b) Deklarata e angazhimit solemn (Model KQZ-04-02);
- c) Deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike (Model KQZ-04-03).

Nga dokumentacioni si më sipër, si dhe nga përmbajtja e kërkesës rezulton se:

- a) Emri zyrtar i partisë është “Partia e Lirisë” me shkronja nistore “ PL”, me adresë: Rruga “Sami Frashëri”, Godina 20/10, Tiranë;
- b) Kryetari i partisë është z. Ilir Metaj, me adresë: Rruga “Sami Frashëri”, Godina 20/10, Tiranë;
- c) Financieri i partisë është zj. Violeta Bushgjokaj, me adresë: Rruga “Sami Frashëri”, Godina 20/10, Tiranë;
- ç) Personi përgjegjes për komunikim me KQZ-në është z. Kreshnik Kolndreu, me adresë: Rruga “Sami Frashëri”, Godina 20/10, Tiranë;
- d) Specimeni i vulës së partisë është i specifikuar.

Kërkesa e paraqitur nga “Partia e Lirisë”, respekton afatin kohor të parashikuar në pikën 1, të nenit 64, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Dokumentacioni bashkëshoqërues i kërkesës, i paraqitur nga “Partia e Lirisë”, është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 64, pika 2, dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1 shkronja “n”, e 2, 64, dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, si dhe të Udhëzimit nr. 2, datë 22.1.2025, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 11 Maj 2025”,

V E N D O S :

1. Regjistrimin e partisë politike “Partia e Lirisë”, me kryetar z. Ilir Metaj, me shkronjat nistore “PL”, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI